9.3 Mineralogjia e vendburimit

Bazuar në studimet e kryera deri më tani, përbërja mineralogjike është: piriti, pirotina, galeniti, sfaleriti, kallkopiriti, arsenopiriti, magnetiti, kubaniti, tetraedriti, valeriti, burnoniti, bulanzheriti, plumoziti, markaziti antimoniti, kuarci, sideriti, Mn sideriti, kalcedoni, biotit, sfen, klorit, pllagjiokllas, spinel dhe mineralizime të antimonit etj.

9.4 Shkalla e hulumtimit

Numri i shpimeve sipërfaqësore në vendburimin e Hajvalisë është 44 shpime, ndërsa numri i shpimeve nëntokësore në vendburimin e Hajvalisë është 194 shpime.

9.5 Rezervat

Për Hajvali janë vërtetuar 1.280 012 t rezerva të xehes me një përmbajtje: Pb~9%, Zn~15%, Ag~83.60%. Badovci me rreth 1447706 t rezerva ku pjesëmarrja e Pb~3.47%, Zn~3.01%, Ag~60gr/t.

Në bazë të hulumtimeve të deritanishme (1982) rezervat prognozuese (C1) të kryera në fushën xeherore në trupin kryesor në Hajvali llogaritet rreth 237 371 ton.

Pb =3.12%; Zn =1.11%; Ag =28.60 gr/t, FeS₂=38.90%, ZnS=23.14%.

Vendi	Viti	Kategorizimi i rezervave	Rezerva indikative(t)	Pb%	Zn%	Ag gr/t	FeS ₂ %	ZnS%
Hajvali	1982	C ₁	237371	3.12	1.11	28.60	38.90	23.14

Tab. 41. Të dhënat mbi rezervat për vendburimin Hajvali

Rezervat e Kategorisë A						
Nr. rendor	Nr. i bllokut të xehes	Rezervat bilance				
		Xehja në (ton)	Pb%	Zn%	Ag gr/t	
I	I/2	18.360	2.88	0.00	88.80	
	I/4	16.279	3.68	1.01	57.00	
	I/5	49.436	4.53	0.82	57.00	
II	II/1	16.150	4.02	1.35	66.65	
	II/2	15.300	7.07	1.08	63.15	
	II/4	30.522	10.42	2.18	53.00	
IV	IV/a/3	867	16.16	0.75	250.0	
	IVd/1	44.182	2.55	0.96	65.00	
	IVd/4	11.084	8.57	1.15	100.0	
	IVf/2	3.060	5.03	0.03	40.0	
V	Va/1	13.175	2.06	1.15	55.0	
	Va/2	26.775	6.57	0.75	76.80	
	Va/3	18.173	7.24	0.30	50.10	
	Va/4	54.080	6.28	0.18	50.00	
V	Ve/1	8.602	8.72	0.41	50.00	
Gjithsejtë		286.045	6.12	0.82	93.60	

Tab. 42. Të dhënat për Xehë të vendburimit sipas Elaboratit E-312, viti 1986.

Punimet minerare (Koordinatat, pusët etj) janë kryer gjatë hulumtimeve të detajuara dhe punimeve minerare tjera të kombinuara.

Në elaboratin nr. E- 298-1982 i titulluar „Gjeologjia e vendburimit të Hjalisë & Kishnicë 1982 (pjesa e parë e hulumtimeve gjeologjike)” figurojnë shpimet (shih në tabelën e më poshtme).

Emërtimi shpimeve	i	Koordinatat	Koordinatat	Kuota	Gjatësia
		Y=	X=	M	m
Sh-19		520014.27	716659.66	765.51	114.60
Sh-19a		520014.27	716659.66	765.51	150.7
Pk-16		319936.87	716705.42	773.61	105.40
Pk-17b		520006.00	716698.82	758.91	167.60
Pk-18		519930.88	716656.93	782.33	50.20
Pk-18a		519930.88	716656.93	782.3	73.40
Pk-7		519939.10	716807.46	756.00	73.20
Pk-10		519995	716806	10	125.30
Pk-11		519943.80	716751	762.79	38.30
Pk-11a		519943.80	716751.09	764.79	80.50
Pk-3		520115.22	718880.38	756.96	70.10
Pk-5		520006.67	716850.70	726	144.30
Pk-6		520092.88	716848.04	756.65	56.50
Pk-6a		520092.89	716848.04	756.63	83.10
Sb-200		519650	716440	-	432.50
Sb-201		519650	716440		500.50
Sb-203		?	?	-	385.10
Sb-198		519989.56	717627.21	828.00	337.3
Sb-199		519989.56	717627.21	828.05	280.0
Sb-196		?	?	-	471.60

Tab. 43. Të dhënat mbi koordinatat e shpimeve sipas Elaboratit E-298, viti 198

10.0 VENDBURIMI KISHNICA

Miniera e Kishnicës është njëra ndër vendburimet më të rëndësishme të Pb-Zn në fushën xeherore “Hajvali-Badovc-Kishnicë”.

10.1 Pozita gjeografike

Vendburimi mineral „Kishnica” gjendet 15 km në JL të Prishtinës në hapësirën e fushës xeherore të Hajvali-Kishnicë, i cili shtrihet në pjesën bregore të Rrafshit të Kosovës, prej Maticke Utrinës në Veri deri tek Janjeva në Jug, me një gjatësi 10 km dhe gjerësi 4-5 km. Gjendet në juglindje të Prishtinës përkatësisht në pjesën më veriore të fushës xeherore. Fusha xeherore “Hajvali-Badovc-Kishnicë” gjendet në lindje të pellgut neogjen të Kosovës dhe kufizohet në mes $21^{\circ} 29'$ të gjatësisë gjeografike lindore dhe $42^{\circ} 21'$ të gjerësisë veriore sipas Grinuiçit. Në aspektin morfologjik treva e studimit paraqet një terren kodrinoro-malor. Shikuar në përgjithësi relievi përbëhet nga disa tërësi, mirëpo relievi malor përbën fizionominë kryesore të kësaj hapësire gjeografike. Megjithatë, relievi më tepër i takon atij kodrinoro-malor se sa fushor që karakterizohet me lartësi mbidetare mbi 1000m. Këto vargmale kanë drejtim të shtrirjes V-VP me ngritje graduale duke filluar nga perëndimi për në lindje. Në verilindje terreni karakterizohet nga zhveshja erozionale që e kushtëzojnë lumenjtë e përrenjtë të kësaj treve. Pamjes morfologjike të tanishme i kanë paraprirë predispozicioni i lëvizjeve tektonike që janë zhvilluar në Terciar.

10.2 Gjeologjia e vendburimit

Në ndërtimin gjeologjik të fushës xeherore marrin pjesë formacionet dhe seritë litologjike (hartat gjeologjike) me karakteristika sikundër: peridotitet e serpentinizuara, serpentinitet, diabazet, andezitet, latitet, gnaiset, rreshpet sericitebiotitike, kuarcsericitet, shkëmbinjte e gjelbër, filitet, mergelët, ranoret, konglomeratet, gëlqeroret, flish, argjila dhe depozitimet aluvialo – deluviale të Kuarternarit.

Serpentinitet paraqesin pjesën më të madhe të shkëmbinjve ultramafit. Shkëmbinjte kristalin përbëjnë pjesën perëndimore në mes Hajvalisë dhe shkëmbinjte kristalin,

serpentinite të Jurasikut, Kretakut të poshtëm, Kretakut të sipërm, Flishet e sedimentuara, shkëmbinj të vullkanik dhe brekçiet, Peridotitet (Harcburgitet), Dunitet dhe Andezitet.

10.3 Mineralogjia

Mineralet që ndodhen brenda formacioneve që e ndërtojnë këtë zonë sipas E-312 -1985 janë:

- Mineralet xeheror: pirotinë, galenit, hallkopirit, valerit, hallkopirit, sfalerit, arsenopirit, tetradrit, bullanzherit, plumozit, bornit, kovelin, lelingit, malkmalit etj.
- Mineralet jo xeheror: kuarci, siderit, mangan-siderit, mangan-kalcit, kalcit, rodohrozit dhe kalcedon.
- Mineralet relikte; kromit, magnetit dhe ilmenit.
- Mineralet sekondare: anglezit, ceruzit, epsomit, grosularit, melanterit, gips dhe limonit.

10.4 Shkalla e hulumtimit

10.5 Përshkrimi i punimeve hulumtuese

Me metoda dhe punime hulumtuese të realizuara më herët (gjeologjike, gjeokimike, gjeofizike, hidrogeologjike), të punuara disa herë, është përfshirë e gjithë hapësira e vendburimit dhe rrethina e tij. Metodatat e hulumtimit janë aplikuar varësisht nga ndërtimi i terrenit. Disa pjesë të terrenit në masë të madhe janë mbuluar gati me të gjitha metodatat e hulumtimit.

Në hapësirën xeherore Hajvali-Kishnicë është ndërtuar harta strukturale dhe metalogjenike 1:10 000 dhe 1: 25 000.

Si rezultat i hulumtimeve të ndryshme në Kishnicë janë konstatuar një numër i trupave xeheror në thellësi të ndryshme.

Me metoda gjeokimike janë përfshirë 26 km² me rrjet 800x200, kurse në zonat me përmbajtje më të lartë të Pb dhe Zn rrjeti është 200x100m.

Me metoda gjeofizike janë përfshirë këto zona: Badovci, Kishnica, Maja e mprehtë-Shashkovac, Badovci i vjetër-Prroi i djaloshit, Shashkovc-Janjevë etj.

Me shpime hapësira është e mbuluar si rezultat i të cilave kemi konturimin e trupave xeheror dhe rezervave.

Në Kishnicë deri në periudhën e hartimit të E-312-1985 janë realizuar 64 shpime sipërfaqësore me gjatësi të përgjithshme 10,281,53 m. dhe 35 nëntokësore me gjatësi të përgjithshme 2023.94m.

Që nga fillimi i eksploatimit të vendburimit e deri në periudhën e raportimit janë realizuar këto punime minerare hulumtuese:

Periudha	Korridore (m)	Periudha
1960-1981	10.547.23	2.293.26
1981-1984	2.459.10	231.9
Gjithsejtë	13.006.33	2.525.16

Tab. 44. Të dhënat mbi punimet minerare sipas Elaboratit E-312, 1985

Sipas punimeve minerare të hapura, gërmimeve dhe rezervave të reja të gjetura, efektet e hulumtimit të vendburimit janë si në tabelën më poshtë:

Lloji i punimeve minerare	Gjatësia në (m)	Intensiteti i hulumtimeve mm/T		Efektet e hulumtimit	
Koridore	2.459,10		6.72		2.49
Punime (Puse)	231.9	365.902	0.63	985.879	0.24
Gjithsejtë	2.691		7.35		2.73
Shpime nëntokësore	2.884,5		7.88		2.92
Shpime sipërfaqësore	6.106,1	365.902	16.69	985.879	6.19
Gjithsejtë	8.990,6		24.57		9.12
Gjithsejtë punime hulumtuese	11.689,6	365.902	31.92	985.879	11.84

Tab. 45. Të dhënat mbi punimet minerare sipas Elaboratit E-312, viti 1985

Rezervat sipas E-312-1985 janë:

Kategoria	Xehe (t)	Rezervat Gjeologjike			Rezervat Eksploatuese			
		Pb%	Zn%	Ag g/t	Xehe (t)	Pb%	Zn%	Ag g/t
A	795.085	3.84	0.89	52.97	726.726	3.84	0.89	52.97
B	1.313.457	3.67	1.02	51.73	1.202.426	3.67	1.02	51.73
C1	1.118.943	4.32	1.47	57.38	951.101	4.32	1.47	57.83
A+B+C1	3.227.485	3.94	1.15	54	2.880.253	3.94	1.15	54

Tab. 46. Të dhënat mbi rezervat e vendburimit sipas Elaboratit E-312, viti 1985

Gjendja e rezervave të balancuara për 1984 është 3.227.485 t me: Pb= 2.94%; Zn=1.15%; Ag= 54.00 gr/t

Gjendja e rezervave jashtë balance më 1984 është 3.079.645 t me: Pb=2.87%; Zn=0.77%; Ag= 40.16 gr/t

10.6 Shpimet

Referuar Elaboratit E-212 viti 1985, janë kryer 20 shpime me gjatësi prej 3740.2 m gjatësi shpimi.

Emërtimi i Shpimeve	Koordinatat	Koordinatat	Kuota	Gjatësia
	Y=	X=	m	m
Sh-19	520014.27	716659.66	765.51	114.60
Sh-19a	520014.27	716659.66	765.51	150.7
Pk-16	319936.87	716705.42	773.61	105.40
Pk-17b	520006.00	716698.82	758.91	167.60
Pk-18	519930.88	716656.93	782.33	50.20
Pk-18a	519930.88	716656.93	782.3	73.40
Pk-7	519939.10	716807.46	756.00	73.20
Pk-10	519995	716806	10	125.30
Pk-11	519943.80	716751	762.79	38.30
Pk-11a	519943.80	716751.09	764.79	80.50
Pk-3	520115.22	718880.38	756.96	70.10
Pk-5	520006.67	716850.70	726	144.30
Pk-6	520092.88	716848.04	756.65	56.50
Pk-6a	520092.89	716848.04	756.63	83.10
Sb-200	519650	716440	-	432.50
Sb-201	519650	716440	-	500.50
Sb-203	?	?	-	385.10
Sb-198	519989.56	717627.21	828.00	337.3
Sb-199	519989.56	717627.21	828.05	280.0
Sb-196	?	?	-	471.60

Tab. 47. Të dhënat mbi koordinatat e shpimeve sipas Elaboratit E-312, viti 1985

11.0 VENDBURIMI BADOVC

Të gjitha karakteristikat që e përcjellin vendburimin e Kishnicës janë të përafërta me ato të Badovcit.

Kategoria	Sasia (t)	Pb %	Zn %	Ag gr/t	As gr/t	Fes ₂
Totali	1898360	3.37	2.77	45.7	-	-

Tab. 48. Të dhënat mbi rezervat e vendburimit Badovc

12.0 VENDBURIMI GLAMA

12.1 Pozita gjeografike

Paraqitja xeherore Gllama ndodhet rreth 5 km në veriperëndim të Gjilanit në rrethinën e fshatit Strazha. Deri te paraqitja xeherore mund të arrihet nga drejtimi i Gjilanit përmes fshatit Stanishor, nga ana e Artanës përmes fshatit Bostan dhe Makresh i epërm kurse në periudhat e thata përmes Prekovcit dhe Zebnicës. Është terren kodrinoro malor me lartësinë mbidetare më të lartën deri në 1002 m. Paraqitja xeherore ndodhet në nivelin 750m.

12.2 Gjeologjia

Në ndërtimin gjeologjik të terrenit të hulumtuar marrin pjesë këta formacione lito-stratigrafik:

- Seria e Velesit - për nga përbërja ky kompleks është heterogjen dhe ndërtohet nga: rreshpet filitike, biotitike, biotit-kloritike, kuarc-sericitike, amfibolike, aktinolite, amfibol-kloritike, gnajseve dhe mermerëve.
- Kompleksi vullkanogjeno sedimentar i jurasikut- i cili kompleks në ndërtimin e tij ka: serpentinitet, gabrot, diabazet, granitoidet dhe keratofiret, argjila, gëlqerorët, ranorët dhe konglomeratet.

Kompleksi sedimentar:

- a) formacioni diabaz-stralor është i ndërtuar nga rreshpet argjilore, ranorët, konglomeratet, serpentinitet dhe diabazet;
- b) gëlqerorët e Glamës shtrihen mbi formacionin diabaz strallor dhe arrijnë trashësinë deri 300 m.

Kretaku i sipërm - shkëmbinjtë e kretakut të sipërm nga terreni i hulumtuar ndërtohen nga ranorët liskunor të kuqërremtë, argjilat dhe mergelët me ngjyra të ndryshme.

Depozitimet kuaternare ndërtohen nga shtresat deluviale dhe aluviale. Në zonat më të ulëta të këtyre depozitimeve kemi rërë dhe zhavorr të përzier me material argjilor.

12.3 Mineralogjia

Mineralet që ndodhen brenda formacioneve që e ndërtojnë këtë zonë sipas E-14 -1985 janë: mallahit, hallkopirit, pirit, hallkozin, kovelin, bornit, oksid titani, relikte të kromitit, talijumi, kadmiumi, indijumi, galijumi, bariumi, galenit, sfalerit, Au dhe Ag etj.

12.4 Shkalla e hulumtimit

Hulumtimet e para që dihen janë ato të anglezëve në periudhën 1927-1934, ku kanë gërmuar 5 punime minerare në formën e puseve thellësia e të cilave arrin deri 100 m.

Punimet hulumtuese të pas luftës (Lufta e II-të Botërore), për këtë periudhë vlen të ceket puna e Dr Vas, Simic me titull Kosovska-moravska oblast i cili në studimet e tija jep këto të dhëna për xehet okside: Fe-35.5%; Mn-19.0%; Sio₂-0.83%; Ni-0.0%.

Rezultatet më të reja të vëllimit dhe dedikimit të ndryshëm në hapësirat e gjëra dhe të ngushta të zonës për studim kanë filluar më 1976 që kanë zgjatur deri më 1985. Këto hulumtime kanë qenë të karakterit metalogjenik, të cilat janë realizuar duke grumbulluar analizat e shlifeve, sedimentet ujore, hulumtimet gjeokimike regjionale dhe detale, gjeofizike, ndërtimin e hartave si 1:10 000 dhe planeve gjeologjike 1:2.500, shpimeve kërkimore etj. Në hapësirën hulumtuese Glama përveç mineralizimeve të Pb-Zn-Cu dhe elementeve tjera përcjellëse janë gjetur edhe mbetje të xehes së hematit dhe magnetit.

12.5 Hulumtimet gjeokimike

Gjithsejtë janë marrë 11 prova nga të cilat prova 10 dhe 11 janë marrë nga bërthama e shpimit, 8 dhe 9 janë marrë nga gërmimet etj.

Më poshtë po paraqesim tabelën e cila paraqet rezultatet e analizave nga provat e marra sipas metodave gjeokimike.

Nr i provës	Pb%	Zn%	Cu%	Bi%	Cd%	Sn%	Mn%	Fe%	Au g/t	Ag g/t
1	3.00	2.30	0.09	0.01	0.024	0.03	0.07	12.30	3.60	12.40
2	2.80	2.60	0.22	0.01	0.016	0.09	0.27	12.10	23.76	77.00
3	0.72	2.22	0.23	0.01	0.007	0.07	5.80	9.50	3.10	11.50
4	0.94	0.68	0.02	0.005	0.004	0.06	14.02	2.10	16.83	19.40
5	0.38	0.74	0.01	0.005	0.002	0.12	16.20	1.50	18.48	24.80
6	1.62	1.48	0.10	0.005	0.008	0.06	7.30	6.00	9.57	32.20
7	0.20	0.07	Gjurmë	-	-	Gjurmë	-	-	-	2.30
8	0.30	0.30	0.01	0.03	0.01	0.10	50.00	4.56	0.92	9.2
9	1.32	15.20	0.06	0.04	0.01	0.10	0.20	48.00	1.18	6.9
10	Gjurmë	0.03	-	-	-	0.08	1.40	0.46	Gjurmë	6.0
11	Gjurmë	0.03	-	-	-	0.05	2.50	2.15	0.36	5.5
12	Shlif	-	-	-	-	-	-	-	8.65	12.06
13	shlif	-	-	-	-	-	-	-	8.32	84.8

Tab. 49. Të dhënat mbi përmbajtjen e elementeve kimike në provat e vendburimit Glamë nga Elaborati E-14, viti 1985

Hulumtimet me shpime - me programin trevjeçar të hulumtimeve: është paraparë të realizohen 10 shpime (në elaboratin nr E-14- 1985) figurojnë vetëm dy shpime.

Rezultatet e hulumtimeve me shpime janë si më poshtë:

Shpimi G1- prova ½ ka nga analizat e bëra kemi këto rezultate:

Pb%=gjurmë; Zn=0.08; Au g/t=gjurmë; Sn%=0.075; Fe%=0.46; Mn%=1.40

Shpimi G1- prova 1/3, nga analizat e bëra kemi këto rezultate:

Pb%=1.3; Zn=0.08; Au g/t=-; Sn%=0.05; Ag g/t=0.363; Fe%=2.15; Mn%=2.5

(Shpimi G2- mungojnë të dhënat).

13.0 VENDBURIMI DRAZH NJA (ÇUKA E BATLLAVËS)

13.1 Pozita gjeografike

Miniera e Çukës së Batllavës gjendet 12 km në juglindje të Besianës në trekëndëshin e fshatrave Hërticë - Turan - Batllavë. Lidhjet e komunikimit të minierës me Besianën dhe Prishtinën janë relativisht të mira. Me Prishtinën lidhet përmes rrugës së asfaltuar prej 39 km dhe 5 km rrugë të paasfaltuar përmes luginës së lumit të Turanës.

Rajoni karakterizohet me një reliev malor. Edhe pse ndryshimet e lartësive janë mjaftë të theksuara megjithatë format relievore janë mjaftë të buta. Lartësia më e lartë mbidetare është Çuka (1018 m) kurse lartësia më e ulët përgjatë luginës së lumit të Hërticës është 693 m. Ujërat e përrenjve përmes lumit të Hërticës dhe Turanës derdhen në liqenin e Batllavës.

13.2 Gjeologjia

Rajoni i Çukës së Batllavës në përgjithësi është i ndërtuar nga krijimet e Paleozoikut, Jurasikut, Sendimenteve të Kretakut dhe efuziveve të terciarit.

Seria e shkëmbinjve të paleozoikut ose e ashtuquajtura "Seria e Velesit" përfaqësohet nga gnajset, amfibolitet, rreshpeve kuarcsericitike, filiteve, mermerëve, kalkshisteve dhe kuarciteve që do të thotë se kemi të bëjmë me një metamorfizëm të shkallëve të ndryshme.

Në përfundim seria e paleozoikut është në një raport tektonik me ranorët e kretakut dhe serpentinitet, kurse në veri dhe në lindje mbulohet nga sedimentet vullkanogjene të terciarit. Materiali primar nga e cila është krijuar seria e paleozoikut ka qenë e një përbërje të shumëllojshme duke filluar nga përfaqësuesit e ranoreve, mergeleve dhe gëlqerorëve. Nën ndikimin e metamorfizmit regional të shkallës së mesme dhe të lartë ranoret kuarcorë kanë dhënë kuarcitet, kurse komponenta e parë gëlqerore ka dhënë mermerët dhe kalkshistet. Anëtarët e tjerë të paleozoikut janë formuar gjatë metamorfozës së ranorëve, argjilave të përbërjeve të ndryshme dhe shkëmbinjve jo të pastër karbonatik.

Sendimentet e jurasikut paraqiten kryesisht me serpentinitet përgjatë kontaktit të krijimeve të kretakut dhe rreshpeve të paleozoikut.

Kretaku paraqitet me sendimentet flishore të ndërtuara nga konglomeratet, ranoret, argjilat, mergelet dhe kanë një përhapje shumë të madhe e që në të vërtetë janë pjesë e trupit të sendimenteve flishore të zonës së Vardarit. Kufijtë me anëtarët rrethues litostratigrafik kryesisht janë tektonik dhe shtrihen mbi krijimet e jurasikut dhe rreshpeve kristalin.

Krijimet e terciarit në ndërtimin e fushës xeherore të Çukës së Batllavës kanë një përhapje shumë të madhe duke ndërtuar pjesën lindore dhe jugore të rajonit e që në të vërtetë përfaqësojnë pjesën perëndimore të masivit andezit të Leckës.

Kompleksi vullkanogjeno-sedimentar i terciarit mbulon pothuaj të gjithë anëtarët më të vjetër gjeologjik dhe ka rol të veçantë në formimin e mineralizimeve xeherore. Në krijimet e terciarit mund të dallohen tri nivele: seria bazaltike, kompleksi vullkanogjen dhe paleoceni. Seria bazaltike ndërton pjesën dyshemore të terciarit dhe përfaqësohet nga argjilat e zeza dhe më pak blloqeve të tufiteve. Në kuadër të kompleksit vullkanogjen dallohen tufet andezitike brekqet vullkanike aglomeratet andezitet dhe kuarclatitet.

Sedimentet e pliocenit dhe kuaternarit shtrihen mbi sedimentet e kretakut dhe kryesisht janë argjila ranore dhe ranorë të shkatërruar.

13.3 Ndërtimi gjeologjik i vendburimit

Ndërtimi gjeologjik i vendburimit është relativisht i thjeshtë: ndërtohet nga mermeret serpentinitet dhe kompleksit vullkanogjeno-sedimentar. Vendosja hapësinore e mineralizimit të Çukës është rezultat i faktorëve struktural, litologjik, magmatik dhe faktorëve gjeokimik. Krahas faktorëve struktural, faktori litologjik ka pas rol vendimtar në formën dhe madhësinë e xeherorizimit. Masa karbonato-silicore e cila është formuar në llogari të serpentiniteve dhe mermerëve nga aspekti fiziko-kimik kanë qenë të volitshme për deponimin e xeherorit kurse mbulesa vullkanogjeno sedimentare ka pasur rol ekranizues.

Sulfidet e Pb - Zn si karbonate të përziera të Fe - Mn u takojnë tipit kompakt dhe impregnativ - shtokverg të xeherorizimit. Tipi kompakt i xehes është formuar nën gushën e hapësirave të zonave shkarëse dhe ndërfitjen selektive metasomatike në masën karbonatosilicore dhe gëlqerorë. Tipi shtokverk impregnativ i xeherorizimit është formuar me kombinim selektiv të ndërfitjeve metasomatike dhe karbonate, dhe mbushjen e qarjeve në masën karbonato-silicore. Në përgjithësi masa karbonato-silicore ka ramje prej 45°.

13.4 Rezervat

Trupi xeherore II është konturuar në galerinë jugore në strukturën Çukë - Lajthishtë. Në nivelin 695 m ka sipërfaqe cca 6000 m² me përmbajtje 3.16% Pb dhe 7.31% Zn. Në nivelin 749 m ky trup ka sipërfaqe cca 9000 m² me përmbajtje 1.29% Pb dhe 2.89% Zn.

Rezervat e përgjithshme të llogaritura nga instituti gjeologjik i kombinatit të Trepçës në vitin 1989 rezultojnë të jenë:

Kat. A - 467.707 t, 2.09% Pb, 4.26% Zn, 25 gr/t Ag

Kat. B - 1.168.735 t, 3.16% Pb, 6.98% Zn, 47 gr/t Ag

Kat C₁ - 3.097.584 t, 2.23% Pb, 4.25% Zn, 47 gr/t Ag

Shuma: 4.734.027 t Pb - 2.44%; Zn - 4.92% ;Ag - 45 gr/t

Si rezerva perspektive të kategorisë C₂ llogariten të jenë 2.000.000 t, ndërsa të kategorisë D₁ - 4.000.000 t.

Pra rezervat e përgjithshme të fushës xeherore të Çukës së Batllavës janë cca 11.000.000 t.

14.0 VENDBURIMI BELLASICË

14.1 Pozita gjeografike

Hapësira hulumtuese ndodhet në VL të Kosovës, në VP të Podujevës, në planshetin e Skromës 2, me shkallë 1:10.000. Në këtë hapësirë mundet të arrihet përmes rrugës së asfaltuar prej Podujevës. Tereni është tipik kodrinoro-malor me lartësi mbidetare përtej 1200 m.

Rrjedha kryesore e kësaj zone është lumi i Murgullës me një numër të madh të rrjedhave më të vogla, të cilat në fakt paraqesin burimin e lumit Llap i cili gjatë tërë vitit është i pasur me ujë. Në hapësirën hulumtuese ndodhen një numër i madh vendbanimesh ndër të cilat më i madhi është ai i Kërpimehit.

14.2 Gjeologjia e vendburimit

Në ndërtimin gjeologjik të kësaj zone bëjnë pjesë: Serpentinitet; formacioni diabaz strallor; sedimentet e kretakut të poshtëm dhe atij të sipërm; andezitet, kuarclatitet, bazaltët, listfenitet etj.

Peridotitet e serpentinizuara përbëjnë vazhdimin e masivit serpentinit të Ibrit. Formacionet diabaz strallor janë të vendosura në jugë të zonës serpentinite dhe ndërtohen nga: ranorët, seria e rreshpeve argjilore, strallorët, mergelëve dhe gëlqerorëve pllakor me shtresa të holla.

Sedimentet e kretakut të poshtëm shtrihen në pjesën jugore të zonës dhe në këtë rast kemi të bëjmë me sedimente të karakterit flishor të cilat flishe ndërtohen nga ranorët, argjilat, mergelët dhe gëlqerorët pllakor.

Sedimentet e kretakut të sipërm vendosen në perëndim të hapësirës dhe në vete përmbajnë facie të gëlqerorëve dhe flishit.

Andezitet dhe kuarclatitet janë shumë prezent sidomos kuarclatitet e njohura në Borovik dhe Rëzhanë.

Bazaltet kanë shtrirje të panjohur, paraqiten në afërsi të hapësirës për hulumtim në Qukën Kërkin.

Listvenitet përfaqësojnë krijimet më të reja të hapësirës.

Në bazë të hulumtimeve të deri tanishme mundet të konstatohet se në rrethinën e këtij tipi të xeherorizmit (skarne) dallojmë dy nëntipa tjerë si: tipi i xeherorizmit skarn dhe tipi i xeherorizmit kalimtar nga skarne në hidrotermal. Tipi i parë përfaqësohet me paragjenenzën xeherore të magnetit-pirotinë. Kurse tipi i dytë përfaqësohet me paragjenenzën piritite- galenite-sfalerite, e cila dominon në hapësirë.

Paraqitjet xeherore më së shumti i gjejmë në ranorët e kretakut, gëlqerorët dhe gëlqerorët ranorik.

14.3 Mineralogjia

Bazuar në metodat e hulumtimit të aplikuara në këtë zonë dhe analizave laboratorike rezulton se në Bellasicë janë prezentë mineralet si më poshtë: Antigorit i silifikuar, Sfalerit, Pirit-limonit, Klorit, Galenit, Kuarci, Feldshpati, Karbonati, Cirkoni, Turmalina, Muskovit.

14.5 Shkalla e hulumtimit

Në kuadër të punimeve hulumtuese janë përfshirë 30 km me studime hartogafuese detale me prospektim të lëndëve minerale.

Janë marrë 1265 prova nga oreolët sekondare për analiza me rrjetin 100x20 m.

Në vendet e zgjedhura në aluvionet e lumit të Murgullës si Ostro Kople dhe lumi i Bajgorës gjithsejtë janë marrë 31 shlife. Për këtë punë hulumtuese kemi rezultatet e analizave laboratorike si në tabelën në vijim.

Tabelat në vijim paraqesin analizat laboratorike të marra nga E-355-1989

Nr. rend.	Emri i mostrës	Galenit ^o %	Sfalerit	Arsenopirit ^o %	Limonit ^o %	tjera
1	Mr-4/88	-	-10	-	3	87
2	Mr-7/88	10	19	-	-	71
3	Mr-11/88	-	-	-	-	100
4	Mr-14/88	-	8	-	6	86
5	Mr-19/88	-	3	-	40	57
6	Mr-20/88	Gjurmë	Gjurmë	-	8	92
7	Mr-24/88	-	9	-	7	84
8	Mr-26/88	4	10	-	10	76
9	Mr-27/88	-	Gjurmë	-	Gjurmë	100
10	Mr-30/88	-	Gjurmë	-	gjurmë	100

Tab. 50. Mineralet në % në provat e dhëna sipas Elaboratit E-355, viti 1989

Analiza mineralogjike detale e provave MR-20/88 fraksioni jo magnetik

Nr. ren	Prova	Përbërja mineralogjike	%
1		Kuarci	10
2		Feldshpati	24
3	Mr-20/88	Karbonati	30
4		Cirkoni	3
5		Turmalina	Gjurmë
6		Muskovit	Gjurmë
7		Pjesë shkëmbore	33

Tab. 51. Mineralet në % në provat e dhëna sipas Elaboratit E-355, viti 1989

Fraksione të mëdha

Nr. rend.	Prova	Përbërja mineralogjike	%
1		Copa shkëmbore	72
2		Antigorit i silifikuar	10
3	Mr-20/88	Sfalerit	Gjurmë

4		Pirit-limonit	8
5		Klorit	10
6		Galenit	Gjurmë

Tab. 52. Mineralet në % në provat e dhëna sipas Elaboratit E-355, viti 198

Tabela në vijim përmban analizat laboratorike të nxjerra nga E-337

Elementet						
Nr.	Shenja e provës	Pb%	Zn%	Cu%	Au g/t%	Ag g/t%
1	Tumba I	0.3	0.31	Trag	0.06	10
2	Punim i Vjetër I	8.6	0.36	0.01	0.06	50
3	Punim I Vjetër II	0.01	0.02	Trag	1	20
4	Rovina I	3.6	0.17	0.03		40
5	Rovina II	Trag	0.02	0.03	0.1	
6	Rovina III	0.07	0.01	Trag	0.06	10
7	Tumba Shahta	0.02	0.03	Trag	0.03	30
8	Oblava Glava I	0.01	0.02	0.68	10	10
9	Oblava Glava II	0.02	0.02	Trag		10
10	P5	0.03	0.03	Trag	0.03	10
11	T1				0.06	10
12	T2				0.1	10
13	Tumba III	0.03	0.03	0.02	0.1	1.8
14	Krushefica	1.21	0.17	Trag	0.03	9.8
15	Gropa Rusha	2.35	0.72	0.02	0.03	8.5

Tab. 53. Përmbajtja e elementeve kimike sipas Elaboratit E-337

14.6 Rezervat

Meqë në këto hapësira nuk janë realizuar hulumtime detale (shpime), nuk kemi një pasqyrë të rezervave xeherore të Pb-Zn.

Rezervat e Kategorisë A					
Nr. rendor	Nr.i bllokut të xehes	Rezervat bilance			
		Xeheja në (ton)	Pb%	Zn%	Ag gr/t
I	I/2	18.360	2.88	0.00	88.80
	I/4	16.279	3.68	1.01	57.00
	I/5	49.436	4.53	0.82	57.00
II	II/1	16.150	4.02	1.35	66.65
	II/2	15.300	7.07	1.08	63.15
	II/4	30.522	10.42	2.18	53.00
IV	IV/a/3	867	16.16	0.75	250.0
	IVd/1	44.182	2.55	0.96	65.00
	IVd/4	11.084	8.57	1.15	100.0
	IVf/2	3.060	5.03	0.03	40.0
V	Va/1	13.175	2.06	1.15	55.0
	Va/2	26.775	6.57	0.75	76.80
	Va/3	18.173	7.24	0.30	50.10
	Va/4	54.080	6.28	0.18	50.00
V	Ve/1	8.602	8.72	0.41	50.00
Gjithsejtë		286.045	6.12	0.82	93.60

Tab.54. Të dhënat mbi rezervat sipas Elaboratit E-377

Punimet minerare (Koordinatat, pusët etj)- janë kryer gjatë hulumtimeve të detajuara dhe punimet minerare tjera të kombinuara (E-312, 1986).

15.0 VENDBURIMET POLIMETALORE TË- Cu, DRAGASHI ME RRETHINË (E-105,1988/90)

15.1 Pozita gjeografike

E 105 Raport për hulumtimet gjeologjike të lëndëve minerale polimetalore në rrethinën e Dragashit 1988 “Geoinstitut” Beograd 1990

Rrethina e Dragashit ndodhet në JP të pellgut të Dukagjinit (Plansheti i Prizrenit dhe Gostivarit 1: 100 000). Kryesisht është terren kodrionoro-malor me ekonomi të dobët. Lidhet me rrugë të asfaltuar Prizren - Dragash-Brod. Në perëndim të Dragashit ndodhet Koritniku me lartësi 2.394m. kurse në Lindje dhe Jug shtrihen malet e Sharrit me lartësi mbidetare 2207 në Lindje, 1940 në Jug. Në aspekt hidrografik zona është e mbuluar me lumenj si: Lumi Brod, Radeshka, Plava.

15.2 Gjeologjia e vendburimit

Në ndërtimin gjeologjik të Vendburimeve të polimetalore - Cu, Dragash hyjnë:

- Metaranorë, kuarcor, kuarcite, metakonglomerate, shkëmbinjë bazikë të metamorfizuar (Paleozoiku);
- Rreshpe gëlqerore, konglomerate, albit, sijenit (Permotriasi);
- Sedimentet liqenore, materialmorent (Kuaternari).

E-104,1990 - Cu, Dragash - (Palezoiku) Rreshpet kristalore me ortokerasim; krinoidet dhe koralet, metaranorët dhe kuarcitet, metakonglomerate dhe shkëmbinjë bazik të metamorfizuar;

- (Permo-Triasiku) Rreshpe filitike metamorfike, kallkshiste, rreshpe gëlqerore, albitike, konglomerate, albit-sijenite;
- (Kuaternari) Sedimentet e kuaternarit janë formuar sikur se të Pleistoceni dhe Holeoceni, proluvion, deluvion etj.

E-241,1984 - Cu, Pashtrik - Shkëmbinjtë me përbërje bazike, gabrot, diabazet, spiliti, dhe keratofiri,

- Peridotitet e serpentinizuara,
- Gelqerorët e Karboniferit,
- Formacione të reja si sedimentet e neogjenit,
- Serpentinitet, lertzolitet e serpentinizuara dhe harzburgitet, piroksenet, diabazet etj.

15.3 Mineralogjia e vendburimit

Ky lokacioni ka këtë përbërje të mineralizimit:

Pllagjiokllas, kuarc, biotit, amfibol, epidot, apatit, klorit, cirko, ilmenit, leukoksen, ilmenit, minerale metalore, pirit, rutil, (Në verilindje të fshatit Baçka -Sm,Mo,Ag,Bi etj. në fshatin Dikancë - janë konstatuar Cu, Wo, Ag; në **E-241,1984 - Cu, Pashtrik** përendim të shpatijeve të Pashtrikut '82/'83/'84, - Cu. hallkopiriti, limoniti, mallahiti, me Ni silikat, Cr, magnetiti, hematiti, petlanditi, valeriti, pirotina, kubaniti etj).

15.4 Shkalla e hulumtimit

Raporti për analiza kimike të mostrave, lokaliteti - Dragash.

Nr.r	Emri i provës	Pb%	Zn%	Cu%	Na ₂ O%	K ₂ O%
1	A-4945	0.0058	0.0029	0.0017		
25	A-4970	0.0015	0.0011	0.0008	1.0	
35	A-4978	0.0015	0.0050	0.000	2.02	3.66
47	A-4992	0.0013	0.0026	0.0003	1.95	4.02
65	A-4965	0.0015	0.0041	0.0065	1.82	2.70
106	A-4906	0.0017	0.0046	0.0003		
157	A-4957	0.0006	0.0023	0.0002		
186	A-4986	0.0010	0.0036	0.0003	3.30	3.36
229	A-4933	0.00113	0.0044	0.0008		
241	A-4949	0.0028	0.0034	0.000	1.51	1.92
311	A-4987	0.0020	0.0066	0.0016		
372	A-4950	0.0011	0.0073	0.0001		

Tab. 55. Të dhënat, mbi përmbajtjen e elementeve kimike sipas Elaboratit E-241, viti 1984 (12 nga 312 prova)

Raport për hulumtime gjeologjike (E-105,1988/90 - Cu, Dragash.

Në elaboratin E-328,1987, janë të evidentuara 4 shpimeDB-1;DB-2.

Koordinatat	Shpimi ,DB-1	Shpimi ,DB-2
Y=	74486788	74487247
X=	47363258	47361987
Thellësia	89 m	61m

Tab. 56. Koordinatat e shpimeve në elaboratin E-328, viti 1987

15.5 Kimizmi

Vendi	Viti	Pb%	Zn%	Ag gr/t	Fe %	Ni %	Cu %
Dragash	1987	0.01	0.02	-	-	0.04	0.01
		0.02	0.03	-	-	0.035	-

Tab. 57. Përmbajtja e elementeve kimike sipas elaboratit E-328, viti 1987

Në E-102 të vitit 1986 - Janë hulumtuar këto lokalitete:

- Baqka Mlika 15km²,
- Milka Kukulan,
- Ovnishtë dhe StranoveLesk.

(Shpime nuk ka, kimizëm nuk ka).

(E-52(100), viti 1985) Janë hulumtuar këto lokalitete:

- Dragash shpatijet e Kornikut në kufi me malet e Sharrit (në Lindje),
- Fshati Dikancë (E-128,1987-K₂O/Na₂O).

Në E-241, viti 1984 - Terreni i Pashtrikut është hulumtuar në pjesën lindore të strukturës faciale të zonës së Mirditës dhe përfundon në Pellgun e Metohisë dhe janë evidentuar këto shpime: DB-1 deri DB-9 por vetëm dy prej tyre kanë rezultuar pozitivisht, DB-5 dhe DB-6. (Shih.Tab. e mëposhtme).

Lokalitet./ Viti	Emër. i shpimit	Gjatë.e shpimit (m)	Cu%	Cr %	Pb%	Zon.e hulu.	Mineralizimi i xeheror
Pashtrik 1980;	DB-5	-	-	-		80 km ²	
	DB-6	8.8	0.30-5.20				
	DB-1	41-41.10 47-47.10	1.9 0.48				
	DB-2	Nuk e ka takuar trupin xeheror	-				
Devë-Bokrinë-Çafë Prush 1970	Mos.7 Mos.8	5m	6.20 24.50			80 m	
Viti 1971, në 16 lokalitete	965-mostra gjithë.		45ppm (0.0045%) Për vlerë janë marrë 18 anomali. I V, VII, VIII, IX, IXa, IXb, IXc, IXd, X, XII, XV të marra në vullkanitet bazike. Anomalit ((I, II, III, V, VI, VIa, XI V - janë marrë në shk. Ultrabaz.	-Testimi i marrjes së rezultateve të Cr sillet prej 1.314 ppm; 2700-5500ppm; mbi-10000 ppm;	-Rezultatet e marra për Pb; prej 56ppm; 100 - 150ppm; 150-200ppm; mbi -200ppm (Çafaljev, S hljorza); prej 90ppm; 180-200 ppm; 200-400 ppm;	27 km ²	

					mbi -400 ppm		
Vit 1982, në 16 lokalitete	6552 mostra në rrjetin 100x20 .Provat janë marr në thellësi 5-25 cm		48ppm(0. 0048%); -Ndarjet tjera përbëjnë Cu:100pp m;100-150 ppm;150- 200ppm; mbi 200ppm			12 km ² ,	

Tab. 58. Të dhënat nga Elaborati E-241, viti 1984

15.6 Pozita Gjeografike

E 241 - Raport për hulumtimet e Cu - Mineralizimet në ramjet perëndimore të Pashtrikut më 1982-1983 - Geozavod Beograd

Hapësira për hulumtime përfaqëson pjesën JP të pellgut të Dukagjinit. Administrativisht i takon KK të Gjakovës e paraqitur në hartën topografike Çafa e Prushit 1:10 000.

Në aspektin orografik kjo hapësirë përbënë kalimin nga një relief fushoro-bregor në atë kodrinor. Lartësia mbidetare sillet prej 400-1400m. Rrjedhjet sipërfaqësore janë të shumta, mirëpo lumi Reçica është më i madhi, i cili ka ujë gjatë tërë vitit. Të gjitha këto rrjedha gravitojnë drejtë veriut dhe përfaqësojnë fushën grumbulluese nga ana e djathtë e Erenikut i cili i takon rrjedhës së Drinit të Bardhë.

15.7 Gjeologjia e vendburimit (E-52 (100), viti 1985)

Ndërtimi gjeologjik :

- Shkëmbinjtë magmatik (Diorite, sijenitodiorite, monconit, granodiorit),
- Metamorfik (Rreshpe-kuarcsericitike, kloritike-epidotike, gëlqerorë pllakor, ranorë të metamorfizuar dhe kuarcite) dhe
- Sedimentet e Triasikut janë paraqitur në facjet e rreshpeve dhe ranorë, mermer, gëlqeror të mermerizuar dhe dollomite etj.

Në (E-52(100), viti 1985) janë evidentuar 500 mostra, 20 profile, 20m. (50 km²-Ljubiqevë).

- Përbërja e Pb në 500 mostra është konstatuar prej 31-80 ppm.
- Përbërja e Zn në 500 mostra është konstatuar prej 100-150 ppm. (lokaliteti Okravna).
- Në 365.5m janë marrë vetëm 95.50m gjatësi ose 80 mostra.
- Shpimi DK-2=40-47m (Cu,Azurit, Mallahit, Bornit),
- DK-1=8m; DK-2=101m; DK-3=104m; DK-4=80m

Në (E-101, viti 1984) janë paraqitur 3 tabela të analizave kimike nga gjurmimi nr.2. (shih vetëm dy tabelat e më poshtme)

Në tabelat e mëposhtme shihet se analizat kimike të disa provave tregojnë përmbajtje të lartë të elementeve kimike e në veçanti të Cu, Au, Mo dhe Fe. Koncentrimi i Cu në provat Dr1- deri Dr-3 arrin nga 8 deri 11%, Au deri në 2,9g/t, Mo deri në 1,1 % dhe Fe deri në 59,2 %.

Nr. rënd.	Emri i provës	Mo %	Ag gr/t	Pb %	Zn %	Cu %	Ni %	Co%
11	Dr-11/1	Trg.	5	Trg.	0.01	0.05	Trg.	0.01
12	Dr-11/2	II	4	II	0.01	0.27	0.01	Trg.
13	Dr-11/3	II	15	II	0.01	0.03	0.02	0.02
14	Dr-11/4	II	30	0.08	0.01	0.070	Trg.	0.01
15	Dr-11/5	II	10	Trg.	0.01	0.32	II	Trg.
16	Dr-11/6	II	0	0.005	0.02	0.13	0.02	0.01
17	Dr-11/7	II	0	Trg.	0.01	0.05	II	Trg.
18	Dr-11/8	II	5	Trg.	0.01	0.045	0.01	II

Tab. 59. Të dhënat mbi përmbajtjen e elementeve kimike sipas Elabortit E-101, viti 1984

Nr.ren dor	Emri i provës	Mo %	Ag gr/t	Pb %	Zn %	Cu %	Ni %	Au g/t
1	Dr-1	1.14	0.14	1.14	0.14	10.0	Trg.	2.90
2	Dr-2	1.31	0.13	1.31	0.13	11.0	II	2.50
3	Dr-3	0.72	0.12	0.72	0.12	8.60	II	1.38

Tab. 60. Të dhënat mbi përmbajtjen e elementeve kimike sipas Elabortit E-101, 1984

Në E-241,1984 - Cu, Pashtrik- Paraqitja tabelare e analizave kimike si më poshtë:

Nr. rendor	Pb %	Zn %	Cu %	Ni %	Co%	Mn%	Cr%	Fe
9	0.01	0.01	0.22	0.01	Tr	Tr	0.04	43.20
10	0.02	Tr	0.018	0.01	0.01	0.01	0.20	58.40
11	0.01	0.06	0.15	Tr	0.01	0.02	0.06	34.70
12	0.02	0.01	0.033	0.03	0.01	0.12	0.04	44.70
13	0.01	Tr	0.25	0.01	0.01	0.01	0.06	59.20
14	Tr	0.01	0.06	Tr	Tr	0.04	0.02	26.50
15	Tr	0.01	0.36	0.01	0.01	0.03	0.06	57.30
21	0.01	0.04	0.10	0.08	0.08	-	0.064	32.00
22	Tr.	0.05	0.36	0.08	0.008	-	0.14	50.80
23	0.01	0.01	0.18	0.004	0.004	-	0.72	21.50
24	0.01	Tr	0.12	0.006	0.006	-	0.29	54.60
25	0.01	Tr	0.03	0.006	0.006	-	0.10	32.60
26	0.01	0.01	0.07	0.004	0.004	-	0.54	31.20
27	0.01	Tr	0.21	0.006	0.006	-	0.46	56.70

Tab. 61. Paraqitja tabelare e analizave kimike sipas Elaboratit E-241, viti 1984

DISKUTIM

Territori i Kosovës është hulumtuar nga ish Shërbimi Gjeologjik Jugosllav, Geozavod por edhe nga kompani të ndryshme të hulumtimeve. Janë krye hulumtime të shumta si gjeologjike, gjeokimike, gjeofizike etj. Për disa vendburime me perspektivë janë bërë edhe hulumtime për procese teknologjike të aplikimit të këtyre materialeve në Industri.

Bazuar në shkallën e hulumtimeve të tanishme, një hulumtim detal i territorit është i nevojshëm për kërkim të mineraleve metalore dhe Industriale. Mbi bazën e këtyre hulumtimeve janë hapur vendburime të mineraleve të dobishme por ky studim nxjerr në pah nevojën për hulumtime të mëtejme detale të territorit.

Hulumtimet e vendburimeve Polimetalore të Pb, Zn dhe Cu kanë qenë dhe do të jen me rëndësi të veçantë për sektorin minerar. Këto të dhëna ofrojnë informacione, të cilat për disa vendburime janë të mjaftueshme për të bërë planifikim për shfrytëzim dhe hapje të minierave. Ndërsa për disa nuk ofrojnë informacione të mjaftueshme, por këto informacione janë më vlerë sepse ndihmojnë në planifikimin e hulumtimeve detale gjeologjike, gjeokimike dhe gjeofizike, pra mund të shërbejnë si premise për proceset e hulumtimeve gjeologjike. Njëkohësisht këto të dhëna ndikojnë në zvogëlimin e shpenzimeve për eksplorim sepse ofrojnë të dhëna preliminare mbi kimizmin, trashësinë, mineralogjinë e trupit Xeherore por edhe vendin e shfaqjes së mineralizimeve, i cili është faktor i rëndësishëm në orientimin e programe të hulumtimit.

Vullkanizimi i Terciarit i vendosur në Strukturat e Oqeanit të Vardarit me karakter inetermediar deri në acid, është shkaktuar nga proceset e Subduktionit, me të cilin vullkanizëm lidhen gjenetikisht vendburimet polimetalore të Pb-Zn. Ky vullkanizëm mjaft intensiv i shtrire që nga Veri deri në Jug-Lindje të vendit mund të japë edhe shfaqje të tjera të mineralizuara, të cilat me eksplorime detale dhe aplikimin e metodave moderne të analizimit kimik mund të kalojnë në vendburime jo vetëm për Pb-Zn, metale të çmueshëm (Au, Ag), por edhe elemente të rralla.

Në asnjë mënyrë disa të dhëna të këtij projekti nuk mund të sjellin deri të llogaritjet e rezervave të provuara me përjashtime të disa prej tyre, të cilat rezultojnë në rezerva të kategorisë A dhe B, të cilat rezerva mundën lehtë të konvertohen në rezervat të provuara sipas standardeve Internacionale.

Bazuar në këto hulumtime të deri tashme territori i Kosovës mbetet me perspektivë për Hulumtim në veçanti për vendburimet e Pb-Zn, Cu, Ag, Au, Cr, Fe, Fe-Ni, Ni-Co, EGP (Elemente të Grupit të Platinit), minerale Industriale dhe ndërtimore.

Territori i Kosovës e sidomos Zona e Vardarit është një ndër regionet me potencial të madh me Resurse të Pb-Zn, që e bënë Kosovën një ndër vendet me Resurse të Pb-Zn më të mëdha në Evropë.

Definitivisht Kosova disponon Resurse të mjaftueshme të Pb-Zn, meqë territori ofron një perspektivë të mirë për Hulumtim, por njëherit duhet intensifikuar programet e Hulumtimit për Pb-Zn në të ardhmen në mënyrë që Resurset të zbulohen dhe të shfrytëzohen racionalisht.

LITERATURA:

- E-297 Elab. proračuna rudnih rezerv lezista "Novo Brdo" RMHK olova I cinka "Trepca" Ro rudnici I flotacija "kishnica,Novo Brdo"-Prishtina 1986 Prishtinë;
- E-296 Elabora proračuna rudnih rezerva lezista Farbani Potok stanje 31.12.1988 RMHK olova I cinka "Trepca" Ro rudnici I flotacija "kishnica,Novo Brdo"-Prishtina 1986 Prishtinë;
- E- 314 IZVESTAJ : o Izvršenim Geoloskim istraživanjima na području N.Brda u 1988 Geozavod - Beograd 1989;
- E-281 Izvestaj o izvršnim geoloskim radovima na području Novog Brda u 1982 Rudnici i flotacija "Kisnica,N.Brdo"-Pr Sour Geozavod Bg 1984 Beograd;
- E- 312 Elaborat proračun rudnih rezerva lezista „ Kisnica,, RMKH „ Trepca,, Flotacija „ Kisnica - N.Brdo Pristina/1958;
- EL-14 Izvestaj O Geoloskim istraživanjima polimetalicne rudne pojave Glama kod gnjilana Ro Geozavod -Beograd, Odeljenje za istraživanje mineralnih sirovina Beograd 1988;
- E- 337 Izvestaj o Osnovnim geoloskim istraživanjima Olovo-Cinkovih pojava na Belasici kod Podujeva SOUR „ Geozavod,, Beograd / 1984;
- E-403 Izvestaj o geoloskim istraživanjima olova I cinka u području :Ajvalie-Kishnice" 1982 Sour Geozavod BG 1983 Beograd;
- E-355 Izvestaj o istraživanju Pb-Zn mineralizacije na Belasici za 1988 god. RO Geozavod Beograd / 1989.
- E- 324 Izvestaj o istraživanju Pb, Zn mineralizacije na Belasici za 1987 god Geozavod , Ro Institut za istraživanje minerealnih Sirovina Beograd / 1988;
- E- 42 Izvestaj (kopje) o istraživanju Pb-Zn mineralizacije na Belasici za 1988 Ro Geozavod Beograd odel.mineral 1989 Beograd.
- E-11 Izvestaj o izvršenim istraživanjima olovo icinka u rudnom polju trepce u 1983.god

- E-374 Izvestaj : o izvrsnim Istrazivanjima Olova I Cinka u rudnom polju Trepce u 1985 god.
- E-33, ELABORAT : o Kvalitetu I Rezervama operске gline u lokalnosti BIBA kod Urosevca1987.
- E-367, Elaborat o rezervama I kvalitetu cementnih laporca lezista Djeneral Jankovica1989.
- E- 12 (19) IZVESTAJ : o izvrsenim istrazivanjima Olova I Cinka u rudnom polju „ Trepca,,u 1982 god - I deo
- E-396, Izvestaj o izvrsnim istrazivanjima olova I cinka u rudnom polju Trepce 1984
- E-374, Izvestaj : o izvrsnim Istrazivanjima Olova I Cinka u rudnom polju Trepce u 1985 god.
- E-33, ELABORAT : o Kvalitetu I Rezervama operске gline u lokalnosti BIBA kod Urosevca1987.
- E-367, Elaborat o rezervama I kvalitetu cementnih laporca lezista Djeneral Jankovica1989.
- (E- 41, Program I Projekat geoloski istrazivanja Draznje u 1985 god.
- E-304, IZVESHTAJ o osnovnim istrazivanjima Olova I Cinka u Podrucju Kopaonika u 1982 ;183, god Rudno pole Satorica.
- E-8, IZVESHTAJ: o izvrsenim metalogenskim istraz. U podrucju ROGOZNE u 1984 god.
- E-298, Izvestaj o geolosk.istraz.Pb-Zn u podrucju "Ajvalie-Kishnice" u 1982.
- E-316, IZVESTAJ : o Izvrsenim Geoloskim istrazivanjima na podrucju N.Brda u 1985
- E- 298 Izvestaj o geolosk.istraz.Pb-Zn u podrucju "Ajvalie-Kishnice" u 1982

E-312, Elaborat proračun rudnih rezerva lezista „ Kisnica1986),,

E-105, IZVESTAJ : o Geoloskim istraživanjima Polimetalicnih mineralnih sirovina na području opštine Dragas u 1988/90

E-104, IZVESTAJ : o Geoloskim istraživanjima Polimetalicnih mineralnih sirovina na području opštine Dragas u 1988.

E-241, Izvestaj o istraživanju cu minerali zaciju na zapadnim padinama pastrika u 1982 i 1983 god.

E-105, Izvestaj : o Geoloskim istraživanjima Polimetalicnih mineralnih sirovina na području opštine Dragas 1988/90

E-328, Izvestaj o ispitivanju polimetalicnih mineralizacija u predelu velike Jablanice u (na području Dragasa u 1987).

E-328, Izvestaj o ispitivanju polimetalicnih mineralizacija u predelu velike Jablanice u (na području Dragasa u 1987)

E-102,viti IZVESTAJ : o Geofizickim istraživanjima Polimetalicnih mineralnih sirovina na području opštine Dragas u 1986.

E-52(100), Godisnji izvestaj o osnovnim istraživanjima polimetalicne mineralnih sirovina u području so dragas u 1985 g

E-241,viti Izvestaj o istraživanju cu minerali zaciju na zapadnim padinama pastrika u 1982 i 1983 god.

E-101, IZVESTAJ : IZVESTAJ : o Geofizickim istraživanjima Polimetalicnih mineralnih sirovina na području opštine Dragas u 1984.Elezj, Z & Kodra, A (2008): Gjeologija e Kosoves. ISBN 978-9951-00-068